



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/34

Datë: 18.02.2026

Duke bazuar në vendimin me nr. A.nr. 1875/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK), të datës 02.02.2026, me numër protokolli 546/2026, nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); Ligji nr. 03/l-212 i punës, Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Kryetari i Komunës me datë: 18.02.2026, merr këtë:

V E N D I M

ANULOHET në tërësi procedura e pranimit me numër reference **RN00018037** për pozitën “Zyrtar për Procedimin e të Dhënave”, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Komuna e Junikut, e hapur për aplikim nga data 18.06.2025 deri më 17.07.2025.

A r s y e t i m

Zyra e Personelit – NJMBNJ, më datë 06.02.2026, ka pranuar vendimin me numër protokolli 1-155/961 nga Zyra Pritëse – Komuna e Junikut, për anulimin e procedurës së konkursit të shpallur më 17.06.2025, me numër reference RN00018037, për Grupin e Ekonomisë.

Andaj, bazuar në Vendimin me nr. A.nr. 1875/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK), të datës 02.02.2026, me numër protokolli 546/2026, Zyra e Personelit njofton për anulimin në tërësi të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00018037 për pozitën “Zyrtar për Procedimin e të Dhënave”, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Komuna e Junikut.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës, Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Deçan, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

- KPMShCK-së;
- DMZP-së;
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
- Palës;
- Arkivit të Komunës,

